



6 shtator 2013, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Komuna e paguan dy herë faturën e servisimit të automjetit të kryetarit

Në kuadër të projektit të monitorimit të punës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe ka shqyrtuar pagesat për mirëmbajtje dhe riparim të automjetit të kryetarit të komunës, pasi që Raporti i Auditimit për vitin 2012 kishte konstatuar shkelje të procedurave të prokurimit dhe pagesën e dyfishtë të një fature.

Në Raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (mund të shkarkohet në http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPZ_2012_Shqip_9759.pdf) thuhet se “Komuna kishte bërë shpenzime të pa kontraktuara dhe pa procedura të prokurimit për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjetit të kryetarit në vlerë prej 3,977€”, nga viti 2008 deri në vitin 2012. Mirëpo ky autoritet shtetëror ka hasur edhe në një rast kur një faturë është paguar dy herë nga mjetet e buxhetit komunal.

“Ne kemi rishikuar këto pagesa dhe kemi vërejtur se ishte bërë pagesë e dyfishtë e faturës 1892/S në vlerë prej 336€. Kjo faturë ishte prezantuar në faturën përmbledhëse me nr. 001 të datës 10.04.2012 dhe po ashtu edhe si faturë e veçantë e datës 12.12.2011”, thuhet në raportin e ZAP-it.

EC Ma Ndryshe ka kërkuar sqarime nga Komuna e Prizrenit në lidhje me këto lëshime. Përgjigja e vetme është pranuar nga Sektori Teknik, që shpjegon se “me fajin e kryerësit të punëve është bërë duplikimi i faturës nr. 1892/s të paguar paraprakisht me datën 19.04.2012”.

Sektori Teknik ka pohuar se fatura kontestuese me të arritur në komunë më 10.07.2012 nuk ka figuruar si faturë e paguar në pasqyrën financiare të komunës prandaj dhe është dhënë leja për fshirjen e borxhit, pa u vërejtur gabimi.

Në ndërkohë Auditori e ka gjetur këtë lëshim dhe zyrtarët e Sektorit Teknik theksojnë se menjëherë e kanë reklamuar lëndën në servis përkatës dhe pas pajtimit parimor është arritur marrëveshja gojore “që në servisimin e parë të ardhshëm të bëhet kompensimi”. Sektori Teknik thekson se fjala është për pagesën e pjesshme të faturës 001 të datës 10.07.2012 në shumën prej 336,32 euro dhe jo tërësia e saj dhe se në rast të mos realizimit të premtimit nga punëkryesi pagesa do të kërkohet me rrugë ligjore.

EC Ma Ndryshe përkujton konstatimin mbi rrezikun të Auditorit, i cili ia tërheq vërejtjen zyrtarëve komunal se “dështimi i ndjekjes së procedurave të duhura të prokurimit dhe udhëzimeve shoqëruese ka rezultuar me pagesa të pa rregullta dhe humbje financiare për Komunën” dhe se “ekziston rreziku i mëtejshëm se është arritur vlerë e dobët për paranë e shpenzuar për këtë kontratë”.

EC Ma Ndryshe rekomandon Komunën e Prizrenit që:

- Sa më parë të zbatoj rekomandimin me numër 8 të raportit të ZAP-it, me të cilin kërkohet nga Kryetari i Komunës që të shqyrtoj arsyet pse kërkesat e prokurimit publik nuk janë aplikuar në këto raste dhe të sigurojë që janë vendosur kontrole të duhura, në mënyrë që situata të tilla të mos përsëriten;
- Të respektoj dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në çdo shërbim, furnizim e tender;
- Të gjitha pagesat të bëhen në pajtim me kërkesat e kontratës dhe vetëm pasi të jenë bërë verifikimet e duhura se mallrat shërbimet e kontraktuara janë pranuar në sasinë dhe cilësinë e duhur;
- T'i kushtoj kujdes maksimal shpenzimit të parasë publike dhe
- T'i kontrolloj në mënyrë më rigoroze pasqyrat financiare dhe borxhet e papaguara.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit dhe të Mamushës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
 OJQ EC Ma Ndryshe
 Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
 Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
 +381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
 Pristina

Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Mamushës" prej muajit maj 2013 përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.